



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/8 “Mbi Energjinë”;
2. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/9 “Mbi Rregullatorin e Energjisë”;
3. Dispozitat e Udhëzimit të Përkohshëm I_07_2008 “Mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave dhe Çmimeve në Sektorin e Ngrohjes Qendrore në Kosovë për Sezonin e Ngrohjes 2008/2009”;
4. Aplikacionin për tarifën e ngrohjes në sezonin 2008/2009 dorëzuar nga ana e Ngrohësit të Qytetit (NQ) Gjakovë SH.A. Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 24 shtator 2008;
5. Komentet për aplikacionin për tarifën të dhëna nga ana e ZRRE-së me datë 10 tetor 2008;
6. Aplikacionin për tarifën, të rishikuar, të NQ Gjakovë SH.A. dorëzuar me datë 17 tetor 2008;
7. Vendimin V_133_2008 mbi Përcaktimin e të Ardhurave të Lejuara për NQ Gjakovë SH.A. për sezonin e ngrohjes 2008/2009, nxjerrë nga ana e ZRRE-së me datë 21 nëntor 2008, shoqëruar nga ANEKSI “RAPORTI RREGULLATIV – Përcaktimi i të Ardhurave të Lejuara për NQ Gjakovë SH.A., për Sezonin e Ngrohjes 2008/2009”.

Në mbledhjen e mbajtur me datë 21 nëntor 2008, nxori këtë:

VENDIM

1. Të aprovojë tarifën për NQ Gjakovë SH.A. për sezonin e ngrohjes 2008/2009 siç janë paraqitur në tabelën “A” dhe “B” dhe në llogaritjen detale në ANEKSI-in e këtij vendimi.

TARIFAT PËR NGROHTOREN E QYTETIT GJAKOVË SH.A. PËR SEZONIN E NGROHJES 2008/2009
--

Tabela A. TARIFA PËR KONSUMATORËT PA MATJE

NGROHTORJA E QYTETIT GJAKOVË SH.A.		
Komponentet e Tarifave	Konsumatorët shtëpijakë	Konsumatorët Komercialë e Institucionalë
Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse)	0.13 [€m ² për muaj]	0.17 [€m ² për muaj]
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	0.77 [€m ² për muaj]	1.11 [€m ² për muaj]

Tabela B. TARIFA PËR KONSUMATORËT ME MATJE

NGROHTORJA E QYTETIT GJAKOVË SH.A.	
Tarifa mujore e kapacitetit të ngrohjes (komponenta fikse)	1.33 [€kW për muaj]
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	47.62 [€MWh]

2. Tarifën e aprovuara do të publikohen nga ana e NQ Gjakovë SH.A. në njërin nga gazetën ditore që qarkullojnë në Kosovë, brenda (5) ditëve të punës, pas shpalljes dhe publikimit të vendimit nga ana e ZRRE-së në faqen e saj zyrtare në internet.
3. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) do të përdorë të drejtat sipas ligjit, për të verifikuar të dhënat e paraqitura nga NQ Gjakovë SH.A, dhe auditorët regjistrat e kontabilitetit dhe faturat e tyre, në të cilat është bazuar llogaritja e tarifave për sezonin e ngrohjes 2008/2009.



4. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe;
5. Ky Vendim hyn në fuqi datën e aprovimit të tij nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Gjykatën Kompetente në Prishtinë brenda 14 ditëve nga data e miratimit dhe publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Vendimit i bashkëngjitet Raporti rregullativ: "Përcaktimi i Tarifave për NQ Gjakova SH.A. për Sezonin e Ngrohjes 2008/2009"

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues,

Theranda Beqiri, anëtare

Dr. Nysret Avdiu, anëtar